



## Mirë se vini në kantonin e Bernës

**Informacione të dobishme për  
banoret dhe banorët e rinj**

Albanisch/Albanais



Gesundheits- und Fürsorgedirektion  
des Kantons Bern  
Sozialamt, Abteilung Integration

Direction de la santé publique  
et de la prévoyance sociale du  
canton de Berne, Office des  
affaires sociales, Division Intégration



## Të dashura banorë të reja, të dashur banorë të rinj

### Mirë se vini në kantonin tërheqës dhe të gjithanshëm të Bernës. Ne na vjen mirë që keni vendosur të jetoni këtu.

Kantoni e Bernës ka disa qendra urbane, por edhe shumë zona rurale. Më 1 janar 2018 banorin këtu 1'031'126 persona, prej tyre janë 16.2% të kombësive të huaja. Pjesa më e madhe e popullsisë së Bernës jetojnë në qytetet si: Bernë, Biel, Burgdorf dhe në Thun. Me dy gjuhët zyrtare gjermanisht dhe frëngjisht kantoni i Bernës është një kanton dygjuhësor. Gjithashtu ekzistojnë disa komuna dygjuhësore, por në nivelin komunal si gjuhë zyrtare është në shumicën e rasteve vetëm njëra, gjermanishtja apo frëngjishtja.

Për ne është e rëndësishme, të ndjeheni mirë në shtëpinë e re që keni zgjedhur dhe që të mund të adoptoheni sa më shpejtë. Integrimi është gjithmonë një proces i ndërsjellë. Për këtë është i nevojshëm angazhimi i juaj si dhe mirëkuptimi i vendasve. Kjo broshurë ju ofron një vështrim të përgjithshëm lidhur me ofertat dhe shërbimet të cilat ju lehtësojnë fillimin e jetës në kantonin e Bernës. Ju lusim që ta shfrytëzoni këtë! Shumë komuna kanë përveç këtyre edhe ofertat e veta për integrim. Për informacione të tjera lajmërohuni direkt te komuna e juaj.

Shiko gjithashtu: Platformën informative  
[www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)

Broshurën «Mirë se vini në Zvicër»  
[www.sem.admin.ch](http://www.sem.admin.ch) > Publikationen  
& Service > Publikationen /  
[www.sem.admin.ch](http://www.sem.admin.ch) > Publications  
& services > Publications

Uebsiti i kantonit Bernë në gjuhën  
angleze: [www.cantonofbern.ch](http://www.cantonofbern.ch)

## Përmbajtja

Këshillime mbi përditshmërinë dhe integrimin	5
Leja e qëndrimit / Bashkimi familjar	6
Kurse të gjermanishtes, të frëngjishtes dhe të integrimin	9
Puna	10
Banimi	14
Edukimi/kujdestaria për fëmijë/arsimimi	16
Shëndetësia/siguria sociale	21
Mbrojtja nga diskriminimi	26
Tatimet	28
Mobiliteti	29





# Këshillime mbi përditshmërinë dhe integrimin

## Unë kam pyetje të përgjithshme mbi jetën në Zvicër apo dëshiroj të di më tepër mbi temat e caktuara. Kujt mund të i drejtohem?

Keni pyetje specifike mbi gjuhën? Mbi bashkëshortësinë, partneritetin dhe familjen? Mbi dhunën në familje? Mbi shkollë dhe profesion? Mbi financa, ligjësi dhe shëndet? Mbi trajtimet me organet shtetërore? Mbi migrimin dhe moshën?

Zyrat për diskutim integracioni (Ansprechstellen Integration / *Antennes d'intégration*) i këshillojnë të huajat dhe të huajt mbi të gjitha pyetjet në lidhje me integrim. Këto zyra në rast nevojë mund të ju drejtojnë edhe tek organizatat e specializuara më tutje.

Qyteti Bern:

### Kompetenzzentrum Integration der Stadt Bern

Effingerstrasse 33, 3008 Bern  
Tel. 031 321 60 36  
E-Mail [integration@bern.ch](mailto:integration@bern.ch)  
[www.bern.ch/integration](http://www.bern.ch/integration)

Regjioni Emmental-Mittelland-Oberaargau:  
**isa Informationsstelle für Ausländerinnen- und Ausländerfragen**  
Speichergasse 29, 3011 Bern  
Tel. 031 310 12 72  
E-Mail [beratung@isabern.ch](mailto:beratung@isabern.ch)  
[www.isabern.ch](http://www.isabern.ch)

Regjioni Berner Jura-Seeland-Biel:  
**Fachstelle Integration / Service spécialisé de l'intégration**  
Bahnhofstrasse 50 / Rue de la gare 50,  
2501 Biel/Bienne  
Tel. 032 326 12 17  
E-Mail [integration@biel-bienne.ch](mailto:integration@biel-bienne.ch)  
[www.biel-bienne.ch/integration\\_beratung](http://www.biel-bienne.ch/integration_beratung) /  
[www.biel-bienne.ch/integration\\_conseil](http://www.biel-bienne.ch/integration_conseil)

Regjioni Thun-Oberland:  
**KIO Kompetenzzentrum Integration**  
Uttigenstrasse 3, 3600 Thun  
Tel. 033 225 88 00  
E-Mail [kio@thun.ch](mailto:kio@thun.ch)  
[www.thun.ch/kio](http://www.thun.ch/kio)

Një pasqyrë mbi zyrat tjera këshillimi dhe të ofertave i gjeni nën **[www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)**



# Leja e qëndrimit / bashkimi familjar

## Ku mund të informohem për lejen time të qëndrimit B apo C?

Afatin e lejes së qëndrimit B apo C duhet ta zgjasni rregullisht. Varësisht prej formës juridike të lejes së qëndrimit, të azilit apo të emigrantit (L, B, C, G, N, F) Ju keni të drejta dhe detyrime të ndryshme. Se cilat afate vlejné për zgjatjen e lejes përkatëse të qëndrimit? Cilat të drejta dhe detyrime ju shoqërojnë nëse keni statusin juridik të emigrantit? Si mund ta shndërroni lejen e qëndrimit B në lejen e qëndrimit C? Apo si duhet të veproni nëse doni ta bëni kërkesën për nënshtetësinë zvicerane? Në këto pyetje ju gjeni përgjigje te Shërbimi i Migracionit për Kantonin e Bernës (Migrationsdienst des Kantons Bern/*Service des migrations du canton de Berne*) dhe – nëse banoni në qytetet si: Bernë, Biel apo Thun – atëherë te Shërbimet për Banorët të këtyre qyteteve. Informacione lidhur me këtë si dhe për marrjen e nënshtetësisë merrni edhe në

---

### Migrationsdienst des Kantons Bern / *Service des migrations du canton de Berne* (Shërbimi i Migracionit për Kantonin e Bernës)

Eigerstrasse 73, 3011 Bern  
Tel. 031 633 53 15  
E-Mail [midi.info@pom.be.ch](mailto:midi.info@pom.be.ch)  
[www.be.ch/migration](http://www.be.ch/migration)

---

Qyteti Bern:

### Einwohnerdienste, Migration und Fremdenpolizei (Shërbimet për Banorët, Migracioni dhe Policia për të Huajt)

Predigergasse 5, Postfach, 3001 Bern  
Tel. 031 321 53 00  
E-Mail [einwohnerdienste@bern.ch](mailto:einwohnerdienste@bern.ch)  
[www.bern.ch](http://www.bern.ch) > Politik und Verwaltung > Stadtverwaltung > Direktion für Sicherheit, Umwelt und Energie > Polizeiinspektorat > Einwohnerdienste, Migration und Fremdenpolizei

---

---

Qyteti Biel:

**Einwohner- und Spezialdienste /  
Services des habitants et services spéciaux  
(Shërbime për banorët dhe shërbime të  
veçanta)**

Neuengasse 28 / Rue Neuve 28,  
Postfach 1120, 2502 Biel/Bienne  
Tel. 032 326 12 25

E-Mail ESD-SHS@biel-bienne.ch  
www.biel-bienne.ch > Behörden/  
Verwaltung > Direktion Soziales und  
Sicherheit > öffentliche Sicherheit >  
Einwohner- und Spezialdienste /  
www.biel-bienne.ch > Autorités /  
Administration > Direction de l'action sociale  
et de la sécurité > Sécurité publique >  
Services des habitants et services spéciaux

---

Qyteti Thun:

**Einwohnerdienste der Stadt Thun  
(Shërbimet për Banorët e qytetit të Thun-it)**

Hofstettenstrasse 14, Postfach 145,  
3602 Thun  
Tel. 033 225 82 49  
E-Mail einwohnerdienste@thun.ch  
www.thun.ch/einwohnerdienste

---

**Unë dëshiroj ta sjell familjen time  
në Zvicër. Si duhet të veproj dhe  
kush mund të më këshillojë lidhur  
me këtë?**

Informacionet dhe të gjithë formularët e nevojshëm për bashkimin familjar mund t'i merrni te komuna ku banoni ju respektivisht te Shërbimi për Migracion të Kantonit të Bernës (Adresat shiko në Faqe 6). Mbështetje ju ofrojnë edhe zyrat këshilluese integrimi (Ansprechstellen Integration / Antennes d'intégration) (Adresat shiko në Faqe 5). Çiftet binacionale dhe familjet mund të i drejtohen edhe zyrave këshilluese për gra dhe bura me marrëdhënie binacionale (frabina).

---

**frabina Beratungsstelle für Frauen und  
Männer in binationalen Beziehungen  
(frabina Këshillimore për Gratë dhe Çiftet  
Binacionale)**

Kapellenstrasse 24, 3011 Bern  
Tel. 031 381 27 01,  
E-Mail info@frabina.ch  
www.frabina.ch

---

### Unë kam ardhur me anë të martesës në Zvicër. Çka duhet të di?

Keni pyetje mbi të drejtën martesore në Zvicër? Mbi statusin tuaj si i/e huaj pas martesës me një zvicerane resp. me një zviceran apo ne dikë që kate drejtë qëndrimi në Zvicër? Zyrat këshilluese integrimi (Ansprechstellen Integration / Antennes d'intégration) janë për Ju këtu (Adresat shiko në Faqen 5).

Nëse martoheni apo gjatë bashkëshortësisë jeni banorë të Zvicrës atëherë ju i nënshtroheni Ligjit Zviceran për të Drejtën Martesore. Në Zvicër vlen parimi i barazisë gjinore – bile edhe jashtë martesës. Kjo do të thotë, se të dy bashkëshortët në të gjitha çështjet kanë të drejtat dhe detyrat e barabarta dhe të drejtën e barabartë të bashkëvendosjes.

Dhuna në martesë është një delikt zyrtar. Kjo do të thotë se aktet e këtilla duhet të ndiqen penalisht nga autoritetet, pra edhe kundër vullnetit të viktimës.

Një broshurë në 15 gjuhë të ndryshme lidhur me të drejtat dhe detyrimet më të rëndësishme sipas Ligjit Zviceran për të Drejtën Martesore i gjeni këtu:

[www.bj.admin.ch](http://www.bj.admin.ch) Gesellschaft > Zivilstandswesen > Merkblätter / [www.ofj.admin.ch](http://www.ofj.admin.ch) Société > Etat civil > Mémentos

Informacione të tjera gjeni këtu: [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)

Informacione lidhur me tema të ndryshme të martesës binacionale dhe partneritet binacional gjeni këtu: [www.binational.ch](http://www.binational.ch)





# Kurse të gjermanishtes, frëngjishtes dhe të integrimit

## Ku mund të mësoj gjermanisht apo frëngjisht?

Në kantonin e Bernës flitet kryesisht gjermanisht, në disa regjione frëngjisht. Në shkollat e zonave gjermano-folëse flitet gjuha letrare gjermane, por në përditshmëri dialekti, pra gjermanishtja zvicerane. Që të mund të orientoheni në përditshmëri dhe në lëmin e profesionit, është me rëndësi ta kuptoni dhe flisni gjuhën e vendbanimit të ri. Kështu kontaktoni më lehtë me zvicerane/ë dhe e gjeni një punë më shpejtë.

Në kantonin e Bernës ka oferta të shumta të kurseve të gjuhës. Disa ju japin njohuri gjuhësore për situata specifike të përditshmërisë. Shpesh në këto kurse mund të jenë si tema trajtuese informacionet e përgjithshme për jetën në Zvicër, që ndryshe quhen edhe kurse integrimi. Gjatë kurseve mund të kërkonti pjesërisht një kujdestari për fëmijët.

Një pasqyrë mbi kurset gjermanisht dhe frëngjisht në kantonin Bernë jep [www.be.ch/sprachkurse-migration/](http://www.be.ch/sprachkurse-migration/) / [www.be.ch/cours-langue-migration](http://www.be.ch/cours-langue-migration)

Një listë me ofertues të kurseve të integracionit në kantonin Bern gjeni nën [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)

Një vështrim të përgjithshëm lidhur me ofertat e ndryshme mund t'ju japin edhe qendrat kompetente për integrim në regjionin tuaj (shiko adresat në faqen 5). Disa nga këto qendra ofrojnë edhe vetë kurse gjuhe dhe integrimi.



# Puna

## **Unë dëshiroj të punoj në kantonin e Bernës. Si duhet të veproj?**

A posedoni një leje qëndrimi të vlefshme për të huajt pa vërejtjen «me të drejtë pune»? Atëherë paraprakisht lajmëroni te Enti për Regjistrim të Banorëve (Einwohnerdienste / *Service des habitants*) të komunës suaj se keni gjetur punë. Gjithashtu duhet të lajmëroni këtë ent, po që se e ndërroni punëdhënësin.

Po që se nuk keni leje qëndrimi të vlefshme apo nëse posedoni një vizë turisti, atëherë nuk guxoni të punoni.

Informacione për hyrjen në tregun e punës dhe për pagat dhe kushtet e punës mund të gjeni te këto dy organizata të specializuara për këtë lëmi.

---

### **beco Berner Wirtschaft / beco Economie bernoise (Ekonomia e Bernës)**

Laupenstrasse 22, 3011 Bern  
Telefoni: 031 633 58 10  
E-Mail [info.arbeit@vol.be.ch](mailto:info.arbeit@vol.be.ch)  
[www.be.ch/arbeits](http://www.be.ch/arbeits) / [www.be.ch/travail](http://www.be.ch/travail)

---

### **Migrationsdienst des Kantons Bern / Service des migrations du canton de Berne (Shërbimi për Migracionin i Kantonit të Bernës)**

Eigerstrasse 73, 3011 Bern  
Telefoni: 031 633 53 15  
E-Mail [midi.info@pom.be.ch](mailto:midi.info@pom.be.ch)  
[www.be.ch/migration](http://www.be.ch/migration)

---

## Si kërkoj unë punë?

Shpalljet për punë i gjeni në gazetat ditore, njoftimet regjionale dhe të qytetit dhe në internet. Platforma [www.arbeit.swiss](http://www.arbeit.swiss) / [www.travail.swiss](http://www.travail.swiss) përveç ofertave të punës përmban edhe këshill si të kërkon punë.

Ju mund të depononi dokumentacionin tuaj për aplikim pune edhe tek ndërmjetës privat të vendeve të punës në regjionin tuaj. Këta nuk ndërmjetësojnë vetëm punë të përkohshme, por edhe të përhershme.

Përveç kësaj tregoni të gjithë shokëve e shoqeve, të njohurve, të afërmeve dhe fqinjëve që jeni duke kërkuar punë. Shpesh vendet e punës jepen nëpërmjet lidhjeve.

Disa organizata ofrojnë për emigrantet programe speciale mentorësh, projekte për një ngritje me të lehtësuar profesionale si dhe shkollime të mëtutjeshme. Një vështrim të përgjithshëm lidhur me ofertat e ndryshme gjeni këtu:

[www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)

## Ku mund të gjej mbështetje në kërkimin e punës?

Lidhur me këtë mund të këshilloheni te qendrat regjionale për ndërmjetësim të punës Regionalen Arbeitsvermittlungszentren (RAV) / *Offices régionaux de placement (ORP)*. Gjithsejtë 18 vende në kantonin e Bernës i gjeni nën:

[www.be.ch/arbeit](http://www.be.ch/arbeit) /  
[www.be.ch/travail](http://www.be.ch/travail)

Në [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch) gjeni adresa të tjera prej zyrave, të cilat ju mbështetin në rregullimin e dokumentacionit tuaj për aplikimin për punë ose ju këshillojnë lidhur me punën dhe papunësinë.

## Si duhet të veprojmë për të lënë që të njihet diploma ime e huaja?

Jo të gjithë diplomat e huaja njihen në Zvicër. Ekzistojnë zyra të ndryshme për njohjen e diplomave dhe profesioneve të huaja. Zyra kombëtare e kontaktit për njohjen e kualifikimeve profesionale është vendtakimi i parë për pyetje të përgjithshme lidhur me njohjen e diplomave dhe dëshmime të huaja.

---

**Staatssekretariat für Bildung, Forschung und Innovation (SBFI) / *Secrétariat d'Etat à la formation, à la recherche et à l'innovation (SEFRI)* (Sekretariati për Arsim, Kërkim dhe Inovacion)**  
**Nationale Kontaktstelle für die Anerkennung von Berufsqualifikationen / *Point de contact national pour la reconnaissance des qualifications professionnelles* (Zyra kombëtare e kontaktit për njohjen e kualifikimeve profesionale)**

Einsteinstrasse 2, 3003 Bern

Tel. 058 462 28 26

E-Mail [kontaktstelle@sbfi.admin.ch](mailto:kontaktstelle@sbfi.admin.ch)

[www.sbfi.admin.ch/diploma](http://www.sbfi.admin.ch/diploma)

---

Informata mbi njohjen e sistemeve arsimore të huaja ju ofron edhe BIZ Berufsberatungs – und Informationszentren / *OP Centres d'orientation professionnelle* (Qendrat për këshillime profesioni dhe informime). Adresat e tyre i gjeni nën [www.be.ch/biz](http://www.be.ch/biz) / [www.be.ch/cop](http://www.be.ch/cop)

### Si mund të arsimohem më tutje?

Kërkoni në bankën praktike të të dhënave mbi mundësitë e arsimit të mëtejshëm për ofertat në fushën e interesave tuaja:

[www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch) > Aus- und Weiterbildung > Weiterbildung / [www.orientation.ch](http://www.orientation.ch) > Formations > Formation continue

Merrni parasysh edhe informacionet për kualifikimet profesionale për të rritur: [www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch) > Aus- und Weiterbildung > Berufsabschluss für Erwachsene / [www.orientation.ch](http://www.orientation.ch) > Formations > Certification professionnelle pour adultes

Ju mundeni të lajmëroheni tek BIZ Berufsberatungs – und Informationszentren / *OP Centres d'orientation professionnelle* (Qendrat për këshillime profesioni dhe informime), për të marrë një pasqyrë mbi mundësitë e ndryshme të arsimimit të mëtejshëm. Adresat e BIZ-ve/*OP-ve* regjionale i gjeni nën: [www.be.ch/biz](http://www.be.ch/biz) / [www.be.ch/cop](http://www.be.ch/cop)

### Unë dua të filloj diçka të re në aspektin e profesionit. Ku mund të gjej impulse?

Këshillimorja për zgjedhjen e profesionit ju informon me kënaqësi mbi kualifikimet, programet e studimeve dhe arsimet e mëtejshme. Gjatë një konsultimi personi këshillues flet me ju për situatën aktuale dhe ju tregon mundësitë profesionale. Këshillimorja për zgjedhjen e profesionit nuk ndërmjetëson vende pune. Regjistrohuni direkt tek BIZ Berufsberatungs- und Informationszentrum / *OP Centre d'orientation professionnelle* (Qendra për këshillime profesioni dhe informime të regjionit tuaj. Informacione të tjera dhe të dhënat e kontaktit i gjeni këtu: [www.be.ch/biz](http://www.be.ch/biz) / [www.be.ch/cop](http://www.be.ch/cop)



# Banimi

## Unë jam duke kërkuar një banesë! Si duhet të veprojmë?

Shpalljet për banesat e lira i gjeni gjithashtu në gazetën ditore, në njoftuesit e regjionit Tuaj dhe në internet (p.sh. [www.immoscout24.ch](http://www.immoscout24.ch) apo në [www.home.ch](http://www.home.ch)).

Një përpilim të makinave kërkuese për kërkimin e banesave, këshilla për shpërngulje dhe regjistrimin si dhe fletën e informacionit «Wohnen in der Schweiz / Le logement en Suisse» – banimi në Zvicër në 16 gjuhë i gjeni këtu: [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)

Mendoni për atë, që të lajmëroheni brenda 14 ditëve pranë komunës ku banoni, nëse Ju keni ndërruar banesë.

## Ku mund të informohem për të drejtat e qiramarrjes?

Informata mbi çështjet e të drejtës qiramarrëse ju mund të merrni tek organet pajtuese të kantonit (Kantonale Schlichtungsbehörden / *Autorités cantonales de conciliation*). Adresat e organeve kompetente për regjionin tuaj të banimit i gjeni nën [www.be.ch/justiz](http://www.be.ch/justiz) > Schlichtungsbehörden / [www.be.ch/justice](http://www.be.ch/justice) > *Autorités de conciliation*.

Një kontakt i mirë, ku mund të drejtoheni është zyra e Shoqatës së Kantonit për Qiramarrëset dhe Qiramarrësit (Kantonaler Mieterinnen- und Mieterverband / *ASLOCA*). Kjo zyrë u ofron anëtarëve të vet këshillime juridike falas dhe shërbime të tjera lidhur me problemet në çështjet juridike të qiramarrjes.

### Mieterinnen- und Mieterverband Kanton Bern (pjesa gjermanofolëse e kantonit dhe regjioni Biel)

Monbijoustrasse 61, 3007 Bern  
Telefoni: 031 378 21 21  
E-Mail [mv@mvbern.ch](mailto:mv@mvbern.ch)  
[www.mieterverband.ch](http://www.mieterverband.ch)

### ASLOCA Transjura (Berner Jura / Jura bernois)

Rue des Granges 10, Case postale 46,  
2800 Delémont 1  
Tel. 032 422 74 58  
[www.asloca.ch/transjura](http://www.asloca.ch/transjura)

Informacione të tjera dhe këshillimore për çështjet e qiramarrjes gjeni dhe nën [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)





# Edukimi / Kujdestaria për fëmijët / Arsimimi

**Unë jam bërë nënë apo baba dhe kam pyetje lidhur me formën e sjelljes me fëmijën tim të vogël. Ku mund të drejtohem?**

Këshillimorja për nënat dhe baballarët (Mütter- und Väterberatung / *Centre de puériculture*) ju ofron falas të gjithë prindërve orientim, forcim dhe siguri në të qenit nënë dhe baba. Prindërit kanë pyetje të ndryshme që varen nga faza jetësore dhe moshë e fëmijës. Me shërbimet e veçanta, këshillimorja për nënat dhe baballarët (Mütter- und Väterberatung / *Centre de puériculture*) mund t'u përgjigjet të gjitha nevojave të atyre që do të bëhen prindër dhe atë që nga koha e lindjes së fëmijës si dhe që nga viti i parë i jetës e derisa të fillojnë të shkojnë në kopsht. Këso këshillimore ka gati në të gjitha komunat e kantonit të Bernës.

Adresat dhe vendndodhjet i gjeni këtu:  
[www.mvb-be.ch](http://www.mvb-be.ch) / [www.cp-be.ch](http://www.cp-be.ch)

**Si mund të forcohem unë në rolin tim si nënë apo baba dhe të mësoj më tepër mbi temat e edukimit?**

Në takime për familjet, qendra për nënat dhe vendtakimet e lagjeve ka kurse për prindërit. Edhe këshillat e prindërve e shkollave organizojnë aktivitete për prindërit për tema të zgjedhura. Interesohuni në vendbanimin tuaj ose shikoni në portalin për familjet [www.be.ch/familie](http://www.be.ch/familie) / [www.be.ch/familie](http://www.be.ch/familie), cila oferta ka në regionin tuaj.

Për çështjet e edukimit në moshën parashkollore dhe shkollore ofron, përveç kësaj, Këshillimorja për edukimin e kantonit të Bernës (Erziehungsberatung des Kantons Bern / *Service psychologique pour enfants et adolescents du canton de Berne*) ndihmë:

[www.erz.be.ch/erziehungsberatung](http://www.erz.be.ch/erziehungsberatung) / [www.erz.be.ch/spe](http://www.erz.be.ch/spe)

Në raste urgjente ju mund t'i drejtohuni edhe Thirrjes urgjente për prindërit (Elternnotruf):

**Elternnotruf (Thirrja urgjente për prindërit)**

Tel. 0848 35 45 55  
[www.elternnotruf.ch](http://www.elternnotruf.ch)



## Si është i ndërtuar sistemi shkollor i kantonit Bern?

Koha e shkollimit të obliguar zgjatë njëmbëdhjetë vite. Mësimi dhe materialet mësimore janë pa pagesë

Për përgatitje për shkollë të gjithë fëmijët pas moshës 4 vjeçare ndjekin dy vite çerdhen e fëmijëve.

Pas çerdhes së fëmijëve ndjekin gjashtë vite nivelin e parë dhe atëherë hyn në shkollën sekondare 1, e cila zgjatë tre vite

Informata mbi shkolla dhe çerdhe të fëmijëve në shumë gjuhë dom i gjeni këtu: [www.erp.be.ch/elterninfo](http://www.erp.be.ch/elterninfo) / [www.erp.be.ch/info-parents](http://www.erp.be.ch/info-parents)

---

### Erziehungsdirektion des Kantons Bern / Direction de l'instruction publique du canton de Berne (Drejtoria për edukim e kantonit Bernë)

Sulgeneckstrasse 70, 3005 Bern  
Tel. 031 633 84 51,  
E-Mail [akvb@erp.be.ch](mailto:akvb@erp.be.ch) / [oeco@erp.be.ch](mailto:oeco@erp.be.ch)  
[www.erp.be.ch](http://www.erp.be.ch)

---

Pas përfundimit të shkollës së obligueshme janë të hapura shumë mundësi. Më së miri informohuni te BIZ Berufsberatungs- und Informationszentren / OP Centres d'orientation professionnelle ([www.be.ch/biz](http://www.be.ch/biz) / [www.be.ch/cop](http://www.be.ch/cop))

(Qendra për këshillime profesioni dhe informime) për ofertat e ndryshme. Varësisht nga interesi dhe aftësitë mund të vizitohet një profesion (zanat) me maturitet apo pa te, një gjimnaz apo një shkollë e mesme profesionale apo një shkollë tregtare e mesme.

Për të rinjtë që nuk jetojnë akoma gjatë në Zvicër ka kurse të gjuhës dhe oferta ure, të cilat përgatitin për një formim profesional ose për shkollën e mesme. Informacione për kurset e gjuhës merrni tek Zyrat e kontaktit të Integracionit (adresat në faqen 5) ose në [www.be.ch/sprachkurse-migration](http://www.be.ch/sprachkurse-migration) / [www.be.ch/cours-langue-migration](http://www.be.ch/cours-langue-migration). Në kërkimin e ofertave ure ju përkrahin Zyrat e shqyrtimit të ofertave urë (Triagestellen Brückenangebote / Services d'aiguillage solutions transitoires).

---

### Erziehungsdirektion des Kantons Bern / Direction de l'instruction publique du canton de Berne (Drejtoria për edukim e kantonit Bernë)

Regionale Triagestellen Brückenangebote / Services d'aiguillage solutions transitoires (Zyrat rajonale e shqyrtimit të ofertave urë)  
E-Mail [info.cmbb@erp.be.ch](mailto:info.cmbb@erp.be.ch)  
[www.erp.be.ch/triagestelle](http://www.erp.be.ch/triagestelle) / [www.erp.be.ch/service-aiguillage](http://www.erp.be.ch/service-aiguillage)

---

Zvicra posedon një sistem arsimor të dyfishtë. Kjo do të thotë se zanati (profesioni) përbëhet nga pjesa praktike në ndërmarrjen përkatëse si dhe një pjesë teorike në shkollën profesionale. Përgjatë zanatit mund të përfundohet edhe maturiteti profesional. Kjo jep të drejtën për studimet në shkollat e larta profesionale. Kush e kalon, përveç kësaj, provimin suplementar «Passerelle Berufsmaturität – universitäre Hochschulen» / «Passerelle maturité professionnelle – hautes écoles universitaires» (Maturitet profesional kalues – shkolla të larta universitare) mund të studiojë edhe në universitete Zvicerane dhe në shkollat e larta teknike. Kështu që shtegu përmes zanatit (shkollimit të mesëm profesional) është ekuivalent me atë të gjimnazit. Shpesh kjo formë ofron edhe perspektiva më të mira për profesion.

Një vështrim të përgjithshëm mbi rrugët e arsimimit si dhe informacione në gjuhë të ndryshme ka nën [www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch) > Direkteinstieg > Aus dem Ausland / [www.orientation.ch](http://www.orientation.ch) > *Accès direct: Je suis > de l'étranger*

Informacionet për kurset e veçanta të arsimimit i gjeni edhe nën: [www.erp.be.ch](http://www.erp.be.ch) > Berufsbildung ose > Mittelschule / [www.erp.be.ch](http://www.erp.be.ch) > *formation professionnelle* ose > *écoles moyennes* dhe [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)

Një fletë udhëzuese në pesë gjuhë të ndryshme për kalimin në një gjimnaz të kantonit të Bernës i gjeni këtu: [www.erp.be.ch/aufnahmegym](http://www.erp.be.ch/aufnahmegym) / [www.erp.be.ch/admission-gymnase](http://www.erp.be.ch/admission-gymnase)

Në kantonin e Bernës ofrohen në vende të ndryshme rregullisht aktivitete për prindërit, të rinjtë dhe të rriturit e rinj me gjuhë të huaja për zgjedhjen e profesionit: [www.be.ch/biz-migration](http://www.be.ch/biz-migration) / [www.be.ch/op-migration](http://www.be.ch/op-migration)

### Si mund t' i regjistroj fëmijët e mi në shkollë?

E lajmëroni fëmijën tuaj në Administratën e Komunës apo direkt te drejtoria e shkollës në komunën tuaj.

### Unë dëshiroj, që fëmijët e mi të jen mirë të përgatitur për shkollë dhe që para çerdhës së fëmijëve të mësojnë gjermanisht gjegjë. frëngjisht. Çfarë oferta ka?

Pjesëmarrja e rregullt në stacione ditore të fëmijëve, në grup loje apo në familje ditore është një mundësi e mirë për fëmijën Tuaj të e mëson dhe ushtron herët gjuhën e vendit. Më tepër informacione mbi këto oferta Ju gjeni nën [www.be.ch/familie](http://www.be.ch/familie) / [www.be.ch/famille](http://www.be.ch/famille)

Ka edhe kurse gjuhe për prindër, të cilët gjatë mësimi ofrojnë edhe kujdes të fëmijëve, në të cilat fëmijët mësojnë gjuhën. Kësi lloje të kurseve Ju gjeni nën [www.be.ch/sprachkurse-migration](http://www.be.ch/sprachkurse-migration) / [www.be.ch/cours-langue-migration](http://www.be.ch/cours-langue-migration)

### Si duhet të veproj nëse në shkollë ka probleme?

Bisedoni me mësuesit. Ju mund të drejtoheni edhe te Këshillimorja Edukative –Arsimore e kantonit të Bernës (Erziehungsberatung des Kantons Bern / *Service psychologique pour enfants et adolescents du canton de Berne*). Vendndodhjet, adresat dhe numrat e telefonit të këshillimoreve tuaja regjionale i gjeni këtu:

[www.erz.be.ch/erziehungsberatung](http://www.erz.be.ch/erziehungsberatung) / [www.erz.be.ch/spe](http://www.erz.be.ch/spe)

Disa komuna ofrojnë gjithashtu punë sociale shkollore në formë të këshillimeve në rast të problemeve sociale apo personale të fëmijët apo të rinjtë. Edhe vetë shkolla ndihmon që të identifikohen me kohë dhe të ndërmerren masat e nevojshme të problemet sociale, të cilat rrezikojnë suksesin shkollor. Thjesht informohuni te drejtoria shkollore e komunës suaj.

### **Unë dua një kujdestari për fëmijët e mi. Çfarë mundësish ekzistojnë?**

Në kantonin e Bernës mund të jenë në dispozicionin tuaj oferta të shumta jashtë familjare për kujdestarinë e fëmijëve. Për informacione të tjera si dhe nëse keni nevojë për ndihmë për të kërkuar një ofertë të përshtatshme i gjeni këtu: [www.be.ch/familie](http://www.be.ch/familie) / [www.be.ch/famille](http://www.be.ch/famille)

Përveç kësaj ka edhe shkolla ditore, në të cilat Ju fëmijët Tuaj mund të i leni në kujdestari në pauzë të mesditës apo pas mësimit. Normalisht kjo është e integruar në shkollat popullore në komuna dhe bëhet në hapësira të shkollës. Kostot e shkollave ditore llogariten sipas të ardhurave, pasurisë dhe madhësisë së familjes. Një pasqyrë mbi komunat e Bern-ës, të cilat kanë shkolla ditore, si dhe informata tjera Ju di gjeni këtu: [www.be.ch/familie](http://www.be.ch/familie) / [www.be.ch/famille](http://www.be.ch/famille)



# Shëndeti / siguria sociale

## Unë jam i/e sëmurë. Cilin mjek duhet ta konsultoj?

Se te cili mjek dëshironi të shkoni, ju mund të vendosni lirisht vetë. Por ekzistojnë modele të sigurimeve shëndetësore me një zgjedhje të kufizuar të mjekëve. Në numërorin elektronik të Zvicrës [www.local.ch](http://www.local.ch) i gjeni adresat e shumë mjekëve. Nën [www.doctorfmh.ch](http://www.doctorfmh.ch) ju mund të kërkonti për mjekë me njohuri të veçanta gjuhësore si dhe për fushën e specializimit dhe për regjionin. Informacione dhe oferta trajtimi për shëndetin psikik në shumë gjuhë gjeni nën [www.psy.ch](http://www.psy.ch).

Më së miri kërkonti një mjek respektivisht një mjekë shtëpie të cilit/ës i besoni. Në Zvicër në rast sëmundje personat e parë kontaktues për ju janë mjekët/et e shtëpisë. Ata shpesh bile mund t'ju vizitojnë edhe në shtëpi dhe në raste urgjente mund t'i kontaktoni edhe natën dhe në fundjavë. Nëse është e nevojshme do t'ju rekomandojnë më tutje te një mjek/e specialist/e apo për në spital. Pra vetëm në situata të

rrezikshme për jetë drejtohuni direkt në shërbimet urgjente apo në spital.

Për konsultime mjekësore urgjente në qytetin tuaj është në dispozicionin tuaj edhe

për regjionin Bern:

### **CITY NOTFALL AG**

(City urgjenca AG) (çdo ditë 7 h –22 h)  
Schanzenstrasse 4a, 3008 Bern  
Telefoni: 031 326 20 00  
E-Mail [info@citynotfall.ch](mailto:info@citynotfall.ch)  
[www.citynotfall.ch](http://www.citynotfall.ch)

### **Praxiszentrum am Bahnhof**

Parkterrasse 10, 3012 Bern  
Tel. 031 335 50 00  
E-Mail [pzb.bern@hirslanden.ch](mailto:pzb.bern@hirslanden.ch)  
[www.hirslanden.ch](http://www.hirslanden.ch) > Leistungsangebot  
> Ambulante Zentren > Praxiszentrum am Bahnhof Bern / [www.hirslanden.ch](http://www.hirslanden.ch) > *Offre de prestations > Centres ambulatoires > Praxiszentrum am Bahnhof Bern*

Regjioni Biel:

### **notfallpraxisbiel / Cabinet d'urgences Bienne (Ordonancë urgjence Biel)**

Spitalzentrum Biel / *Centre hospitalier Biel-Bienne* (Qendra spitalore Biel)  
Vogelsang 84 / *Chante-Merle 84*  
2501 Biel-Bienne  
Tel. 032 324 48 44 ose  
0900 900 024 (me detyrim pagese)  
[www.notfallpraxisbiel.ch](http://www.notfallpraxisbiel.ch) /  
[www.cabinetdurgencesbienne.ch](http://www.cabinetdurgencesbienne.ch)

---

### Walk-in-Clinic

Unionsgasse 14/Eisengasse 11 /  
Rue de l'Union 14/Rue du Fer 11  
2502 Biel/Bienne  
Tel. 032 344 46 66  
E-Mail [wic@mzb-cmb.ch](mailto:wic@mzb-cmb.ch)  
[www.mzb-cmb.ch](http://www.mzb-cmb.ch)

---

Regjioni Thun:

### Hausärztlicher Notfalldienst Region Thun

Krankenhausstrasse 12, 3600 Thun  
Tel. 033 226 45 56  
E-Mail [public@han-rt.ch](mailto:public@han-rt.ch)  
[www.notfallthun.ch](http://www.notfallthun.ch)

---

### Unë dëshiroj të di më shumë për sistemin shëndetësor të Zvicrës apo për një temë të veçantë. Ku mund të drejtohem?

A keni pyetje specifike për ushqimin dhe lëvizjet? Për fëmijën dhe shëndetin? Për dashurinë dhe seksualitetin? Apo në përgjithësi për përkujdesjen shëndetësore në Zvicër? Broshurat në gjuhë të ndryshme mund t'i shkarkoni apo t'i porositni falas: [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)

### Si mbetem i/e shëndosh?

Të përkujdesni për shëndetin e vet dhe për atë të familjes, kjo është përkujdesja më e mirë dhe e rrit cilësinë e jetës. Mundohuni që të ushqeheni shëndetshëm dhe të lëvizni çdo ditë të paktën 30 minuta (p.sh. shëtitni, shkoni me biçikletë, ushtroni sport).

### A keni pyetje për sjelljen lidhur me varësitë dhe rreziqet dhe dëshironi të merrni ndihmë?

Në portalin online [www.safezone.ch](http://www.safezone.ch) ju gjeni informacione për çështjet e varësisë dhe adresa të pikave të kontaktit në rrethinën tuaj dhe mund të këshilloheni online në mënyrë anonime.

### Si të zgjedh një sigurim shëndetësor?

Sigurimi shëndetësor në Zvicër është i obligueshëm. Kush vendos për të banuar në Zvicër duhet brenda tre muajve të lidhë një kontratë për një sigurim shëndetësor bazë te një shoqatë të sigurimit shëndetësor. Informacione të mëtutjeshme gjeni këtu: [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)

Ekzistojnë sigurime të ndryshme shëndetësore. Ju mund të vendosni vetë se ku do të siguroheni. Çdo shoqatë të sigurimit shëndetësor është e detyruar t'ju pranojë në sigurimin bazë shëndetësor. Me sigurimin shëndetësor bazë do të mbulohen shpenzimet e trajtimeve të mjekët dhe spitalet në kantonin e Bernës. Megjithatë ju duhet të paguani një pjesë të faturës së mjekut dhe spitalit vetë. Kjo është shuma, të cilën duhet ta merrni përsipër ju (Selbstbehalt).

Sigurimi shëndetësor bazë nuk i merr përsipër shpenzimet për trajtimin të mjeku i dhëmbëve. Këtu mund të krahasoni se cili sigurim shëndetësor është për ju më i liri:

**[www.comparis.ch](http://www.comparis.ch)** > Versicherungen /  
**<https://fr.comparis.ch>** > Assurances

Informacione të tjera lidhur me ofertat dhe premittë e sigurimeve të ndryshme shëndetësore i gjeni këtu:

**[www.bag.admin.ch](http://www.bag.admin.ch)** > Versicherungen > Krankenversicherung /  
**[www.ofsp.admin.ch](http://www.ofsp.admin.ch)** > Assurances > Assurance-maladie

Nëse ju fitoni shumë pak, do të keni një premi me subvencion. Kjo do të thotë se federata dhe kantoni e paguajnë një kontribut për preminë tuaj. E drejta për premi të subvencionuar do të verifikohet në mënyrë automatike duke u bazuar në deklarinë e tatimit. Personat e sapoardhur nga jashtë vendit dhe personat me leje qëndrimi B, L, N apo F duhet të parashtrijnë vetë një kërkesë për subvencionimin e premisë të Enti për Sigurimet Sociale dhe Mbikëqyrje të Fondacionit (Amt für Sozialversicherungen / Office des assurances sociales). Atje gjeni informacione të tjera dhe formularët e nevojshëm.

---

**Amt für Sozialversicherungen (ASV) /  
Office des assurances sociales (OAS)  
(Enti për Sigurim Social dhe Mbikëqyrje  
të Fondacionit)**

Abteilung Prämienverbilligung und  
Obligatorium / Service de la réduction  
des primes et de l'application du  
régime obligatoire

(Reparti për Subvencion të Premisë dhe  
Obligimi)

Forelstrasse 1, 3072 Ostermundigen

Tel. 031 636 45 00

E-Mail [asv.pvo@jgk.be.ch](mailto:asv.pvo@jgk.be.ch)

[www.be.ch/pvo](http://www.be.ch/pvo) / [www.be.ch/rpo](http://www.be.ch/rpo)

---

### Çka është AHV/IV?

Die Alters- und Hinterlassenenversicherung (AHV) / *Assurance-vieillesse et survivants* (AVS) (Sigurimi i Pleqërisë dhe Trashëgimtarëve) si dhe Invalidenversicherung (IV) / *Assurance-invalidité* (AI) (Sigurimi i Invaliditetit) janë sigurime të obligueshme në Zvicër. AHV / AVS është sigurim i pensionit të pleqërisë. Gratë marrin pension pleqërie pasi të mbushin 64 vjet, kurse burrat pasi të mbushin 65 vjet.

Sigurimi i Invaliditetit siguron ekzistencën tuaj themelore. Nëse ju p.sh. pas një aksidenti vetëm pjesërisht apo fare nuk jeni të aftë për punë apo për arsye të dëmtimeve shëndetësore që nga lindja nuk është e mundur të punoni.

Nga mosha 18 vjeçe duhet të paguani kontribute për AHV/IV / AVS/AI. Të punësuarve ju ndalen këto automatikisht nga paga. Po qe se nuk keni punë apo punoni të pavarur duhet t'i paguani vetë këto kontribute direkt te arka e AHV/IV / AVS/AI.

---

#### **Ausgleichskasse des Kantons Bern / Caisse de compensation du canton de Berne (Arka për Kompensim e Kantonit të Bernës)**

Chutzenstrasse 10, 3007 Bern  
Telefoni: 031 379 79 79  
E-Mail [info@akbern.ch](mailto:info@akbern.ch)  
[www.akbern.ch](http://www.akbern.ch)

---

Informacione të tjera për AHV/IV / AVS/ AI dhe të gjithë formularët i gjeni këtu:  
**[www.ahv-iv.ch](http://www.ahv-iv.ch) / [www.avs-ai.ch](http://www.avs-ai.ch)**



### **Cilat sigurime të tjera duhet të bëj edhe nëse nuk janë të obligueshme?**

Sigurimet vijuese janë të preferuara. Gati të gjithë personat në Zvicër kanë lidhë kontrata të tilla sigurimi.

#### **Sigurimi në rast aksidenti:**

Nëse jeni duke punuar Ju jeni në rast aksidenti të siguruar nga punëdhënësi. Nëse jeni të punësuar më shumë se tetë orë në javë te i njëjti punëdhënësi, Ju jeni prej tij edhe ndaj aksidenteve jashtë vendit të punës të siguruar. Nëse nuk jeni të punësuar apo punoni më pak se tetë orë në javë, mund ta lidhni p.sh. një kontratë sigurimi ndaj aksidentit te sigurimi i juaj shëndetësor.

#### **Sigurimi për dëmshpërblim (Haftpflicht / Responsabilité civile):**

Nëse ndokujt i shkaktoni ndonjë dëm, Ju keni detyrime ndaj tij. Kjo do të thotë që Ju për dëmin e shkaktuar duhet të paguani. Sigurimi privat për dëmshpërblim Ju mbron nga pasojat financiare për dëmet e tilla. Shpesh me premitë e ulëta Ju jeni të siguruar për dëmet me shuma të larta. Një vështrim të përgjithshëm lidhur me ofertat e ndryshme të sigurimeve për dëmshpërblim i gjeni këtu:

[www.comparis.ch](http://www.comparis.ch) > Versicherungen / <https://fr.comparis.ch> > Assurances

#### **Sigurimi për objektet e shtëpisë (Hausrat / ménage):**

Sigurimi për objektet e shtëpisë u përgjigjet për dëmet që mund të shkaktohen në banesën apo pronën Tuaj; nga zjarri, uji, rreziqet natyrore (si p.sh. stuhitë apo përmytjet), vjedhja dhe thyerjet e qelqit. Pronarët e banesave, nga të cilët merrni banesën me qira, kërkojnë në shumicën e rasteve nga Ju, që të lidhni një kontratë për sigurim të objekteve të shtëpisë. Sigurimi i objekteve të banesës ofrohet shpesh bashkërisht me sigurimin për dëmshpërblim. Një vështrim të përgjithshëm lidhur me ofertat dhe premitë i gjeni këtu:

[www.comparis.ch](http://www.comparis.ch) > Versicherungen / <https://fr.comparis.ch> > Assurances

Informata tjera mbi sigurim gjeni nën [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)



# Mbrojtje nga diskriminimi

## Ku gjej unë mbështetje, kur unë jam prekur nga diskriminimi apo racizmi?

Kantoni dhe komuna kanë urdhrin për eliminim dhe luftim të diskriminimit. E drejta themelore për mbrojtje ndaj diskriminimit racor, ngjyrë të lëkurës, gjinisë, moshës, gjuhës, prejardhjes, mënyrës së jetesës, drejtimit seksual, bindjeve religjioze apo politike si dhe të metave fizike, shpirtërore dhe psikike vlen për secilin person, pavarësisht nga statusi i qëndrimit dhe nga nacionaliteti.

Personat e prekur nga racizmi marrin mbështetje tek këto zyra:

Këshilla juridike për viktime të diskriminimit racist

### **Berner Rechtsberatungsstelle für Menschen in Not (RBS)**

Eigerplatz 5, 3007 Bern

Tel. 031 385 18 20

E-Mail [info@rechtsberatungsstelle.ch](mailto:info@rechtsberatungsstelle.ch)

[www.rechtsberatungsstelle.ch](http://www.rechtsberatungsstelle.ch)

Informata dhe këshilla mbi dhunën dhe racizmin

### **gggfon – gemeinsam gegen Gewalt und Rassismus**

Tel. 031 333 33 40

E-Mail [melde@gggfon.ch](mailto:melde@gggfon.ch)

[www.gggfon.ch](http://www.gggfon.ch)

Informata, këshilla dhe ndërmjetësimi (nëse nuk ka zyra kompetente regjionale):

### **Eidgenössische Kommission gegen Rassismus EKR / Commission fédérale contre le racisme (CFR)**

Inselgasse 1, 3003 Bern

Tel. 058 464 12 93

E-Mail [ekr-cfr@gs-edi.admin.ch](mailto:ekr-cfr@gs-edi.admin.ch)

[www.ekr.admin.ch](http://www.ekr.admin.ch)

Informata dhe oferta tjera për mbrojtje nga diskriminimi dhe luftimi i racizmit gjeni këtu: [www.integration-be.ch](http://www.integration-be.ch)





# Tatimi



Me paratë e tatimit financohen detyra të rëndësishme të shtetit për mirëqenien e përgjithshme të gjithë personave që banojnë në Zvicër. Për shembull në fushat e arsimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe trafikut rrugor.

## Si e paguani tatimin në kantonin e Bernës?

Po qe se as ju e as bashkëshorti/ja i/e juaj nuk posedoni leje qëndrimin C, tatimi do t'u ndalet direkt nga paga (Quellensteuer). Personat me leje qëndrimi C dhe zvicëranet/ët si dhe bashkëshorti/ja duhet çdo vit ta bëjnë vetë deklarimin e tatimit dhe ta dorëzojnë.

Nëse keni pyetje për tatimin drejtohuni te punëdhënësit, te zyra e tatimit të vendbanimit tuaj apo te administrata tatimore e kantonit (kantonale Steuerverwaltung / *Intendance des impôts du canton de Berne*). Në faqen e tyre të internetit gjeni shumë këshilla të dobishme dhe informacione.

## Steuerverwaltung des Kantons Bern / *Intendance des impôts du canton de Berne* (Administrata Tatimore e Kantonit të Bernës)

Brünnenstrasse 66, 3018 Bern  
Adresa postare: Postfach 8334, 3001 Bern  
Telefoni: 031 633 60 01,  
[www.be.ch/steuern](http://www.be.ch/steuern) / [www.be.ch/impots](http://www.be.ch/impots)

## A më duhet të paguaj taksa për radio dhe televizion?

Në Zvicër marrja e radios dhe e televizionit i nënshtrohet detyrimit të taksave. Këto taksa mbliidhen nga Serafe. Këtu duhet të lajmëroheni nëse posedoni një televizor apo radio apo nëse posedoni një pajisje me të cilin mund të merrni programet e radios apo televizionit (p.sh. kompjuter apo smartphone). Çdo amvisni në veti i nënshtrohet detyrimit të taksave. Në amvisëri mund të furnizohen persona me numër të pakufishëm me aparate dhe emisione të ndryshme.

## SERAFE AG

Postfach, 8010 Zürich  
Tel. 058 201 31 67  
E-Mail [info@serafe.ch](mailto:info@serafe.ch)  
[www.serafe.ch](http://www.serafe.ch)



# Mobiliteti

## Si mund të qarkullojë unë me mjete publike trafiku?

Kantoni Bern dhe e tërë Zvicra posedon një rrjet të ndërtuar mirë të linjave të trenit dhe autobusëve. Plane udhëtimi, plane linjash dhe abonimet regjionale do i gjeni këtu: [www.mylibero.ch](http://www.mylibero.ch)

Lidhjet tarifore mundësojnë ndërrimin e mjeteve trafiku me biletë të njëjtë. Në kantonin Bern ekzistojnë këto lidhje tarifore:

Region Bern-Solothurn-Biel-Berner Jura:

### **LIBERO**

[www.mylibero.ch](http://www.mylibero.ch)

Region Thun-Berner Oberland:

### **BeoAbo**

[www.beoabo.ch](http://www.beoabo.ch)

Schweizerische Bundesbahnen SBB / *Chemins de fer fédéraux CFF* (Hekurudhat Federale të Zvicrës) ofrojnë abonime në gjithë Zvicrën. Me një Halbtax-Abo / *abonnement demi-tarif* mundeni të udhëtoni me gjysmën e çmimit me trafik urban. Informacione lidhur me abonimet te Hekurudhat Federale të Zvicrës SBB / CFF si dhe planet e qarkullimit të mjeteve transportuese në tërë Zvicrën mund t'i gjeni në çdo sportel te stacioni i trenave apo këtu: [www.sbb.ch](http://www.sbb.ch) / [www.cff.ch](http://www.cff.ch)

Po qe se dëshironi të merrni një makinë me qira, Mobility-Carsharing ju ofron – krahas shumë qirave të ndryshme të makinave edhe makina të madhësive të ndryshme në 1500 vende në Zvicër. Njëherazi Ju duhet të jeni anëtar i Mobility: [www.mobility.ch](http://www.mobility.ch)

## Çka duhet të kem parasysht nëse unë ngas biçikletë?

Biçikleta – Velo, në dialektin Zviceran– është një mjet qarkullues i shumëdëshiruar në Zvicër. Preferohet të bëhet një sigurim garantimi, që Ju të jeni të siguruar në raste kur ju si biçiklist shkaktoni aksidente. Më tepër informata gjeni në Faqen 25.

Një regjistër të udhëve më të bukura për lëvizjen me biçikletë ju do ta gjeni nën [www.veloland.ch](http://www.veloland.ch) / [www.suissemobile.ch](http://www.suissemobile.ch) apo në Verein Pro Velo, i cili ofron edhe kurse vozitje për fëmijë dhe të rritur.

---

### **Pro Velo Kanton Bern / PRO VELO Canton de Berne (Shoqatë Pro Velo Kanton Bernë)**

Birkenweg 13  
3013 Bern  
Tel. 031 318 54 12  
E-Mail [sekretariat@pro-velo-be.ch](mailto:sekretariat@pro-velo-be.ch)  
[www.pro-velo-be.ch](http://www.pro-velo-be.ch)

---

## Unë e kam marr patentën e shoferit në një vend të huaj. A mund të ngas makinën me këtë patentë?

Ju mund ta ngisni makinën me këtë patentë përgjatë 12 muajve. Më pastaj duhet ta këmbeni atë me një patentë zvicerane. Informacione të tjera dhe formularët e nevojshëm i gjeni këtu: [www.be.ch/svsa](http://www.be.ch/svsa) > Führerausweise / [www.be.ch/ocrn](http://www.be.ch/ocrn) > permis de conduire

Automjet e huaja dhe rimorkiot, nëse ngiten në Zvicër më shumë se një vit, duhet të pajisen me targa Zvicerane. Nëse transportoni me makinën tuaj njerëz apo mallra me pagesë, atëherë ju duhet ta regjistroni automjetin menjëherë.

---

### **Strassenverkehrs- und Schiffahrtsamt des Kantons Bern / Office de la circulation routière et de la navigation (Enti i Qarkullimit Rrugor dhe Qarkullimit të Anijeve të Kantonit të Bernës)**

Schermenweg 5, Postfach, 3001 Bern  
Tel. 031 635 80 80  
E-Mail [info.svsa@pom.be.ch](mailto:info.svsa@pom.be.ch)  
[www.be.ch/svsa](http://www.be.ch/svsa) / [www.be.ch/ocrn](http://www.be.ch/ocrn)

---

### **Çka duhet të di si shofere respektivisht si shofer?**

Në trafikun e Zvicrës vlej në këto shpejtësi më të larta, shmangiet janë të sinjalizuara Brenda vendbanimit: 50 km/h  
 Jashtë vendbanimit: 80 km/h  
 Rrugë automobilistike: 100 km/h  
 Autostrada: 120 km/h

Për shfrytëzimin e autostradës duhet të paguhet një taksë: Juve ju nevojitet një vinjetë për autostradë. Këtë mund ta blini p.sh te dogana në kufi, te pompat e benzinës, në postë apo në kioskë.

Në Zvicër vlen kufizimi i promilëve të alkoolit prej 0,5 promilë. Shoferët profesionist, shoferët e ri, nxënësit të vozitjes, instruktorët e vozitjes si dhe personat përcjellëse nuk guxojnë të konsumojnë alkool para vozitjes (0,1 promilë). Ai i cili me vlera më të larta të alkoolit në gjake vozit një automjet apo udhëheq mësim vozitjeje, duhet të llogaris me sanksione ligjore.

Motoçikleta dhe automjete duhet të lëvizin edhe gjatë ditës me drita të ndezura.

Nëse Ju posedoni automjet tuajin, Ju duheni të bëni sigurim të automjetit. Ky sigurim mbulon dëmet ndaj personave tjera apo gjësendeve në pronë të tjerëve. Pa e bërë këtë sigurim garantimi nuk do pranoni targat nga enti i qarkullimit rrugorë.

**Diese Broschüre ist in folgenden Sprachen erhältlich:**

Deutsch, Französisch, Albanisch, Bosnisch/Kroatisch/Serbisch, Chinesisch (Mandarin), Englisch, Italienisch, Polnisch, Portugiesisch, Spanisch, Tamilisch, Thailändisch, Türkisch.

Download unter [www.be.ch/integration](http://www.be.ch/integration)

2019



**Cette brochure est disponible dans les langues suivantes :**

Allemand, français, albanais, anglais, bosnien/croate/serbe, chinois (mandarin), espagnol, italien, polonais, portugais, tamoul, thaïlandais, turc.

Elle est téléchargeable sous [www.be.ch/integration](http://www.be.ch/integration)

2019